



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0372

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Mobelland” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”, më 15/07/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Mobelland” SH.P.K., me nr. 2024/0372, e datës 29/04/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së”, me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-11, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”.

2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së”, me numër të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri-tenderojë.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 18.09.2023, “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1. Ndërsa me datën 04.04.2024 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë GOE N.SH.T “Neramed & Madekos shpk & Wood Corporation L.L.C”.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 600,000.00 €

Me 09.04.2024, OE “Mobelland” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 17.04.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Mobelland” SH.P.K., me nr. 2024/0372 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mobelland” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit, ndërsa ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur ftesës së tyre për tender, duke e përgaditur tenderin dhe duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara.

Pasi kemi kontrolluar vendimin e autoritetit kontraktues B58, për dhënie të kontratës, si dhe pasi kemi pranuar letrën standarde me të cilën jemi njoftuar si tenderues i eliminuar, duke u bazuar në nenin 10 të LPP-s kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik. AK na ka dhënë qasje në dokumentet e kërkuara me ç'rast kemi vërejtur që grupi i O.E. I propozuar për kontratë ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm për arësyet që do ti sqarojmë më poshtë.

Si arësyetim që jemi eliminuar kemi vërejtur që AK në pikën e parë pretendon që ne kemi ndërhyrë në paramasën e cila ka qenë pjesë e dosjes së tenderit. Më tej thekson që në kolonën e emërtuar “Çmimi total” për të tri (3) kategoritë, ju nuk keni vendosur totalin e çmimit të poentuar. Në vend të sajë ju keni vendosur çmimin për njësi pavarësisht që në dosje të tenderit është përcaktuar vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas çmimit total të poentuar dhe jo sipas çmimit për njësi. Rrjedhimisht pjesa e rekapitullimit në paramasë nuk është në përputhje me çmimet për njësi dhe çmimet e poentuara në tri (3) kategoritë e paramasës. Po ashtu ju në kategorinë e tretë nën pozicionin me nr. 116 keni shtuar edhe një kolonë ku keni përmbledhur shumën e totalit të çmimit për njësi dhe çmimit të poentuar për një copë/sasi (kjo robrikë nuk ka qenë pjesë e formularit të paramasës por është shtuar nga ju). Kështu ju keni plotësuar në mënyrë tërësisht të gabuar formularin e tenderit përkatësisht paramasën e cila është pjesë e formularit të dosjes së tenderit. Prandaj oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme në tërësi në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP-së si dhe në kuptim të pikës 10 të UPP ku thuhet se plotësimi i formularit të tenderit është kusht administrativ i cili në rast se nuk përmbushet, duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione të mëtejshme nga tenderuesi.

Duhet të theksojmë që AK është munduar që të manipuloj me faktet e lartcekura duke u munduar që të konstatoj që ne nuk e kemi plotësuar formularin e dorëzimit të tenderit siç duhet në mënyrë që të zbatohet dispozitat e nenit 59 të LPP-së dhe nenit 10 të UPP-së. Së bashku me ofertën dhe dokumentet tjera është dorëzuar formulari i dorëzimit të tenderit i cili është dorëzuar sipas kërksës së AK dhe dispozitave ligjore të LPP-s. Në paramasën e bashkangjitur nga AK janë renditur kolonat si në vijim:

Pra autoriteti kontraktues në kolonën e fundit nuk ka kërkuar që të vendoset çmimi total I poentuar por çmimi total që nënkupton: sasia e shumëzuar me çmimin për njësi është e barabartë me çmimin total.

Sa i përket rubrikës në kategorinë e tretë nën pozicionin me nr. 116 është kalkuluar vetëm totali i të gjithë artikujve për çmimin për njësi dhe totali i artikujve për çmimin e poentuar në mënyrë që të kalkulohej drejtë çmimet e paraqitura. Ndërsa paramasa nuk është prekur sa i përket artikujve, nuk janë ndryshuar specifikat teknike dhe nuk është bërë kurrëfarë ndryshimi që do të ndikonte në paramasë për tu

konsideruar se është ndryshuar paramasa, thjesht janë bërë kalkulime të çmimeve të ofruar në paramasë për ti paraqitur në formularin e dorëzimit të tenderit. Ndërsa formulari i dorëzimit të tenderit nuk ka të bëjë asgjë me rregullimet e paramasës pasi që është plotësuar në mënyrë të rregullt duke ju përmbajtur kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe nga oferta çmimorja jonë e paraqitur mund të dallohen shumë qartë çmimet për njësi dhe çmimet e poentuara të cilat janë bartur në formularin e dorëzimit të tenderit.

Pretendimi tjetër me të cilin AK është munduar që të na eliminoj është se kinse ne nuk kemi përmbushur kërkesën me nr. 6 në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit përmes së cilës është kërkuar 6 Autorizimi I prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe katalogu/broshura e prodhuesit për pozicionin 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110 dhe 111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +/- 5%) me ç'rast është kërkuar që si dëshmi dokumentare të dorëzohet 6. Kopja e autorizimit me të dhënat e tenderit, kopja e katalogut/broshurës së prodhuesit për poz. 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110 dhe 111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +/- 5%) Mët tej ak thekson se: Ju në ofertën tuaj keni dorëzuar dy katalogje ku njëra është lëshuar nga anëtari i GOE Mobelland SHPK ndërsa tjetri katalog mban logon e kompanisë Tiscomed me seli në Turqi. Njëkohësisht keni dorëzuar 2 deklarata në emër të autorizimeve të prodhuesit ku njëra prej këtyre deklaratave është lëshuar nga vetë anëtari i GOE Mobelland SHPK ndërsa autorizimi tjetër është dorëzuar në emër të kompanisë "Siesta Comfort" SHPK me seli në Gjilan/Kosovë.

Edhe ky pretendim i AK-s është i pa bazë pasi që ne e kemi dorëzuar katalogun për produktet që ne i furnizojmë me pjesë të ndara dhe si prodhues i kompletojmë në mënyrë që të bëhen të gatshme për tregë. Ndërsa sa i përketë autorizimit nga "Siesta Comfort" SHPK ky autorizim është bërë vetëm për artikullin 111 Dyshek per shtrat te pacientit mjekesore, 22kg/m3, rezistent ndaj ujit, antibakterial. Pra këtu nuk kemi të bëjmë me dy autorizime për pozicione të njejta por kemi të bëjmë me katalog për pozicione të cilat kushti i AK nuk ka qenë që të furnizohemi vetëm prej një prodhuesi por që ka qenë e hapur që të përzgjedhën më shumë furnizues. Pra për pozicionin 111 është dorëzuar autorizimi nga "Siesta Comfort" SHPK ndërsa për pozicionet tjera është dorëzuar deklarata e autorizimit nga Mobelland SHPK për të cilat kemi deklaruar se jemi prodhues.

Ndërsa sa i përketë kodeve të veprimtarisë 3250 të parapara në librin e ARBK-së për klasifikimin e veprimtarive ekonomike NACE Rev 2 këtu Autoriteti Kontraktues ka bërë një diskriminim të pa parë pasi që duke i shikuar të gjitha dokumentet e paraqitura nga Grupi i O.E. i rekomanduar shihet qartë që asnjëri nga anëtarët e grupit nuk e ka këtë kod të veprimtarisë. Prandaj këtu O.E. ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-s pasi që na ka diskriminuar për një kërkesë që nuk është paraparë në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë por që për të na eliminuar AK e përdor si pretekst.

Konsiderojmë që konkluzioni i Autoritetit Kontraktues i paraqitur më lartë është vetëm arësyetim fiktiv me të cilin Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit, duke parë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe kemi ofruar çmimin e tenderit më të lirë në mesin e tenderuesve të përgjegjshëm pjesëmarrës për këtë tender me qëllim që të na diskualifikon neve

nga tenderi në fjalë dhe kontratën t'ia jep ndonjë O.E. të paracaktuar, na eliminon neve nga ky tender. Por gjithashtu AK, me qëllim që të na diskualifikon neve nga tenderi në fjalë na eliminon neve nga ky tender dhe shpërblen me kontratë O.E. të cilët kanë ofruar tender më të shtrenjtë se oferta jonë dhe gjithashtu të pa përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues duke vepruar në këtë mënyrë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-s pasi që ka refuzuar ofertën tonë e cila ka qenë ofertë më e lirë ndërsa dispozitat e këtij neni kanë paraparë që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në bazë të këtyre dispozitave Autoriteti Kontraktues duhet ta merr vlerën për parane e që oferta jonë do ta plotësonte një kërkesë të tillë.

Pasi kemi analizuar dokumentacionin e tenderuesit "NTSH NERAMED, Madekos SH.P.K dhe Wood Corporation" SH.P.K të cilin AK ka vendosur që ta shpërblej me kontratë, vërejtëm se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të LPP-së gjatë vlerësimit, pasi që gjatë vlerësimit, nuk i ka zbatuar kërkesat të cilat vet Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin për furnizim me mobilje, ndërsa në pikën nr. 1 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka paraparë kërkesën si vijon: 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) 900.000,00 € dhe si dëshmi ka kërkuar: 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve.(në rast se furnizimi është kryer tek bleresi privat duhet të deshmohet referenca, raporti i pranimit, fatura dhe transaksioni banker) Pasi analizuam referencat e dorëzuara nga Grupi i O.E. të rekomanduar, vërejtëm që grupi i O.E. kishte dorëzuar vetëm referenca për pajisje mjekësore pra vetëm anëtari i grupit Madekos SH.P.K kishte dorëzuar referenca për pajisje mjekësore, por nuk kishte dorëzuar referenca të ngjashme e cila ka të bëjë me furnizimin me mobilje. Pra shihet qartë që grupi i rekomanduar nuk e ka plotësuar këtë kërkesë ndërsa AK edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës tonë për rishshqyrtim të vendimit fare nuk e shqyrton këtë pretendim, por duke u munduar që ta interpretoj në mënyrë të pa përshtatshme, dispozitën e nenit 4 paragrafin 1 nënparagrafin 26 me qëllim që të na paraqesë si palë të pa interesuar vjenë në përfundime qesharake dhe në konstatime të pa bazuara me qëllim të arritjes së qëllimit për shpërblim me kontratë një grup i cili ishte paracaktuar që nga shpallja e kësaj procedure të prokurimit.

Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të Grupit të O.E. të rekomanduar gjetëm që ky grup nuk kishte dorëzuar Katalogun për pozicionin 25 dhe 86. Autoritetit Kontraktues për pozicionin 86 kishte kërkuar sqarim nga grupi i O.E. të rekomanduar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së pasi që në dispozitat e këtij nenin shprehimisht është paraparë që vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive mund të kërkohe sqarim. Në dispozitat e UPP shprehimisht në mënyrë tabelore ishte paraparë që nëse është dorëzuar katalogu por mungojne specifikat teknike duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të më tejme.

Edhe këtu Autoriteti Kontraktues na ka diskriminuar pasi që Grupi i O.E. kishte dorëzuar një katalog nga një furnizues për të cilin nuk kishte autorizim nga prodhuesi.

Ndërsa për pozicionin nr. 25 edhe përkundër që është kërkuar në pikën nr. 6. Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1&9.2 të FDT-së AK nuk e diskualifikon grupin e O.E. pasi që nuk e ka plotësuar këtë kusht.

Në dosje të tenderit tek FDT në nenin 3.1 është paraparë kërkesa formale administrative Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të

kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit; Grupi i O.E. kishte dorëzuar vetëm një dokument blanko në të cilin nuk deklaroi që do të përmbahet specifikacionit teknik të kërkuar nga AK.

Gjithashtu gjatë vlerësimit të ofertës të dorëzuar nga Grupi i O.E. të rekomanduar vërejtëm që Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që O.E. pjesëmarrës në stafin e tyre të kenë një arkitekt i brendshëm dhe dizajn për ambiente të gjitha me minimum 4 vite përvojë pune ndërsa Grupi i O.E. kishte dorëzuar dokumente për një Arkitekti I brendshëm-Bachelor i arteve të bukura në enterier dhe rregullim hapsinor të cilët nuk e kishin noterizuar CV-në sikur është kërkuar në kërkesën në fjalë.

Më tej në pikën nr. 4 AK kishte paraparë kërkesën 4. OE te posedoje mjete, staibilmente, dhe pajisjet makinerike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit (2 automjete pickup te regjistruara), (2 kamion 3.5 Ton te regjisturara).dhe si dëshmi kishte kërkuar:

4. Librezat per autopikap, kamion te ofrohen, per maqinat te ofrohen DUD-at (ne rast kur OE ka marreveshje per shfrytezim te autopikapave dhe kamionit te ofrohen marreveshjet e noterizume me te dhenat e aktivitetit te ketij prokurimit) Gjatë vlerësimit vërehej se AK kishte dorëzuar dëshmi të posedimit të kamionëve me peshën më të madhe se kërkesa e AK-s e cila kishte kërkuar që O.E. të posedoj 2 kamioneta me peshë 3.5 Ton ndërsa Grupi i O.E. kishte dorëzuar 2 kamion me ç'rast pesha e kamionit me targa 01-190-PE ishte 5350 kg

Dhe pesha e kamionit me targa 01-108-OS=4600 kg pra që të dy kamionët e paraqitur ishin mbi 3.5 ton dhe kjo është në kundërshtim me kërkesën e AK- të paraqitur në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Sa i përket këtyr pajisjeve gjithashtu gjetëm që kamionit me targa 01-108-OS=4600 i kishte

skaduar Regjistrimi me 20.02.2024 pra para datës së dorëzimit të tenderit. Ndërsa furgonit me targa 01-894-ZB nuk i shihet regjistrimi dhe ne kemi arsye që të besojmë që O.E. nuk i ka parqitur të dhënat e regjistrimit pasi që edhe ky atumjet është i pa regjistruar. Pra sikur shiet Grupi i O.E. të rekomanduar nuk e ka plotësuar pikën 4 të cekur më lartë.

Shihet qartë që Autoriteti Kontraktues, duke e favorizuar O.E. të rekomanduar ka shkelur parimet bazike të prokurimit të cilat janë paraparë në nenin 4 të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik sikur janë:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parane për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori

Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga

Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Andaj favorizimi i një O.E. gjatë vlerësimit si dhe diskualifikimi i O.E. tjetër për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parapara as në dosje të tenderit dhe as në njoftimin për kontratë paraqet shkelje të rëndë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të parapara në nenin 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, AK ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-s, pasi që na eliminon nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të paracaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Në dispozitat e paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-s shprehimisht është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pra sikur shihet AK e cilëson si të përgjegjshëm grupin e O.E. i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e cekura më lartë. Andaj konsiderojmë që Autoriteti

Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s dhe Neni 40 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit. Ndërsa në paragrafin 40.13 të Rregullores ka paraparë që AK do të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Andaj Autoriteti Kontraktues duke na eliminuar në mënyrë arbitrare ka bërë shkelje të këtyre dispozitave.

Gjithastu gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të Raportit të vlerësimit ne gjetëm mospërputhje të mëdha të realitetit me përshkrimet që ishin bërë në këtë raport. Të gjitha kërkesat formale administrative në raport ishin paraqitur si të pa përgjegjshme ndërsa në tenderin tonë shihet se janë dorëzuar të gjitha këto dokumente.

Pasi që sikur dihet në këtë tender ka pasur disa kërkesa për rishqyrtim të kriterëve diskriminuese të cilat janë përshtatur Grupit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës si dhe pasi që nuk janë eliminuar kriteret diskriminuese janë bërë Ankesa në OSHP ku në bazë të vendimit të OSHP-s është konstatuar që janë vendosur kriteret diskriminuese. Sikur është paralajmëruar në këto ankesa kriteret i janë përshatur grupit të O.E. të rekomanduar me ç'rast është konstatuar që specifikat I janë përshtatur kompanisë të prodhimit të inventarit medicinal Turmed. Pra me rastin e qasjes në dokumenta kemi konstatuar që me të vërtetë prodhuesi nga Turqia Turmed ka autorizuar kompaninë Madekos SHPK andaj është vërtetuar që ky tender ka qenë i kurditur mirë për të shpërblyer me kontratë këtë grup të Operatorëve Ekonomik të parazgjedhur ende pa u bërë njoftimi për kontratë. Ne si O.E. kemi dyshim të bazuar që kjo zyre e

prokurimit është e korruptuar bashkë me Grupin e O.E. fituese pasi që kemi pasur përpjekje nga disa zyrtar të institucioneve të ndryshme të involvuar në këtë projekt të korruptuar që të na detyrojnë të tërhiqemi nga gara dhe mos të dorëzojmë tenderin për këtë procedurë të prokurimit sepse kjo punë është e kryer dhe është përcaktuar fituesi i këtij projekti, pra i njejtij grup i O.E. fitues të këtij tenderi.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Mobelland” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni: 1, 7, 28, 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 4, 19, 40, 41 të rregullores nr.01/2022 për prokurimi Publik Duke u bazuar në nenin 106 të LPP-s, si dhe në rrethanat dhe faktet e cekura më lartë, kërkojmë nga OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në fjalë, të shqyrtoj faktet e paraqitura në ankesën tonë dhe pas vërtetimit të fakteve të cekura më lartë të marr: VENDIM APROVOHET, si e bazuar ankesa e GOE: Mobelland SH.P.K. ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se për dhenie të kontrates dhe lënda të kthehet në RIVLERESIM dhe të urdhërohet Autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave të behet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore të LPP-së në mënyrë që të rishqyrtojnë vendimin me të cilin kanë propozuar për kontratë një Gr. Të operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë dhe të merren parasysh dokumentet e ofruara në tenderin tonë të cilat dëshmojnë që kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm.”

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Nga administrimi i ofertës së parashtruesit por edhe dosjes së tenderit në rastin konkret është gjetur se Grupi i Operatorëve Ekonomik "Mobelland Sh.P.K. & Interlab Sh.P.K." Rruga "Xhavit Sylaj" p.n. Suharekë, është tenderues i papërgjegjshëm në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP lidhur me nenin 40 par. 40.6 dhe 40.7 të RRPP. Konkretisht është konstatuar që parashtruesi ka ndërhyrë në paramasë dhe ka plotësuar gabimisht paramasën e cila është pjesë e kësaj dosje të tenderit. Në kolonën e emërtuar "Çmimi total" për të tri (3) kategoritë, parashtruesi ka vendosur totalin e çmimit të poentuar. Në vend të saj parashtruesi ka vendosur çmimin për njësi pavarësisht që në dosjen e tenderit është përcaktuar se vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas çmimit total të poentuar dhe jo sipas çmimit për njësi. Rrjedhimisht pjesa e rekapitullimit në paramasë nuk është në përputhje me çmimet për njësi dhe çmimet e poentuara në tri (3) kategoritë e paramasës. Po ashtu në kategorinë e tretë nën pozicionin me nr. 116 parashtruesi ka shtuar edhe një kolonë ku është përmbledhur shuma e totalit të çmimit për njësi dhe çmimit të poentuar për një copë/ sasi (kjo rubrikë nuk ka qenë pjesë e formularit të paramasës por është shtuar nga ju). Kësisoj është gjetur se parashtruesi ka plotësuar në mënyrë tërësisht të gabuar formularin e tenderit përkatësisht paramasën që është pjesë e formularit të dosjes së tenderit. Prandaj oferta e parashtruesit është vlerësuar si e papërgjegjshme në tërësi në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP si dhe në kuptim të pikës 10 të UPP ku thuhet se plotësimi i formularit të tenderit është kusht administrativ i cili në rast se nuk përmbushet, duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione të mëtejshme nga tenderuesi. Tutje është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesën me nr. 6 në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit përmes të cilës është kërkuar "6. Autorizimi i prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe katalogu/broshura e prodhuesit për poz. 23,

24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione $\pm 5\%$)" me çrast është kërkuar që si dëshmi dokumentare të dorëzohet "6. Kopja e autorizimit me të dhënat e tenderit, kopja e katalogut/brosurës së prodhuesit për poz. 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione $\pm 5\%$)". Prashtruesi në ofertën e tij ka dorëzuar dy katalogje ku njëra është lëshuar nga anëtari i GOE "Mobelland Sh.P.K." dhe tjetri katalog mban logon e kompanisë "Tiscomed" me seli në Turqi. Njëkohësisht janë dorëzuar edhe dy (2) deklarata në emër të autorizimeve të prodhuesit ku njëra prej këtyre deklaratave është lëshuar nga vet anëtari i GOE "Mobelland Sh.P.K." ndërsa autorizimi tjetër është lëshuar nga kompania "Siesta Comfort Sh.P.K." me seli në Gjilan/Kosovë. Fillimisht duhet cekur se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim me pajisje me inventar dhe pajisje mjekësore. Nga të dhënat e biznesit në ARBK është gjetur se operatori ekonomik "Mobelland Sh.P.K." nuk ka të regjistruar kodin e veprimtarisë 3250 "Prodhimi i instrumentave dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare" ku sipas librit të ARBK për klasifikimin e veprimtarive ekonomik NACE Rev.2 (shih fq. 238) përfshihet edhe prodhimi i mobilerisë mjekësore dhe të ngjashme. Duke marrë parasysh këtë fakt katalogu i ofruar nga "Mobelland Sh.P.K." nuk mjafton për të përmbushur kërkesën nr. 6 të kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit të cituar më sipër. Kjo për arsye se "Mobelland Sh.P.K." nuk është prodhues i pajisjeve mjekësore sipas kodit përkatës të veprimtarisë ekonomike të ARBK. Rrjedhimisht edhe deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga vet anëtare i GOE "Mobelland Sh.P.K." nuk mjafton për të përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Kuptohet që përmes dosjes së tenderit është kërkuar autorizimi përkatës nga prodhuesi mirëpo në rastin konkret vet parashtruesi është deklaruar si prodhues përkundër faktit se nuk e ka kodin përkatës të veprimtarisë. Sa i përket katalogut tjetër të prodhuesit "Tiscomed" me seli në Turqi, fillimisht ky katalog përmban fotografi të produkteve të cilat mund të gjenden në faqe të ndryshme të internetit por jo edhe në faqen e kompanisë "Tiscomed" në emër të cilës figuron katalogu.

Përndryshe edhe ato produkte në këtë katalog, si të tilla nuk përkojnë me produktet e kërkuara me specifikat teknike të dosjes së tenderit. Si shembull mund të merret pozicioni 111 ku është kërkuar "Dyshek për shtrat të pacientit mjekësore, 22kg/ m.3, rezistent ndaj ujit, antibakterial, dimensionet 90x190x14cm" i cili në katalog evidentohet me dimensione krejt tjera të cilat janë 85x190x12 që si të tilla nuk janë në përputhje me specifikat teknike sipas pozicionit 111. Sa i përket autorizimit të prodhuesit "Siesta Comfort" me seli në Gjilan, fillimisht nuk është përputhje me katalogun sepse bëhet fjalë për dy (2) firma krejt të ndryshme (katalogu në emër të firmës me seli në Turqi ndërsa autorizimi në emër të firmës me seli në Gjilan). Për më tepër autorizimi nuk përmban të dhënat e tenderit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit dhe po ashtu i referohet vetëm pozicionit 111 mirëpo nuk përfshinë edhe pozicionet tjera për të cilat është kërkuar autorizimi i prodhuesit. Për këto arsye është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur as kërkesën nr. 6 të kapacitetit teknik dhe profesional sipas dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë është konstatuar se arsyet sipas të cilave parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshme janë arsye tërësisht të argumentuara dhe të mbështetura në provat përkatëse. Rrjedhimisht të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të drejtuara kundër tenderuesit tjetër në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund. të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilido person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Në fakt oferta e tenderuesit të rekomanduar është e vetmja ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0372/24, ndërsa me datë 27.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0372 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Mobelland” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0372 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1: “Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.372/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-KK Prishtinë, OE ankues në mënyrë të gabuar ka plotësuar paramasën, ku në kolonën e “çmimi total” nuk është vendosur çmimi total i poentuar, si dhe duke bërë ndërhyrje në paramasë duke shtuar rubrikën për totalin e pozicioneve të grupit. OE ankues pretendon se i njëjti e ka plotësuar paramasën në mënyrë të rregullt, pasi në paramasë nuk është kërkuar totali i “çmimit të poentuar”, ndërsa sa i përket ndërhyrjes OE ankues pretendon se *“Ndërsa paramasa nuk është prekur sa i përketë artikujve, nuk janë ndryshuar specifikat teknike dhe nuk është bërë kurrëfarë ndryshimi që do të ndikonte në paramasë për tu konsideruar se është ndryshuar paramasa, thjesht janë bërë kalkulime të çmimeve të ofruar në paramasë për ti paraqitur në formularin e dorëzimit të tenderit”*.

Përgjigje nr. 1: “Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe dosje së tenderit, fillimisht sqarojmë dhe konfirmojmë se në paramasë askund nuk është sqaruar apo kërkuar se tek kolona çmimi total duhet të vendoset “çmimi i poentuar”. Megjithëse qëndron pretendimi i AK-së se OE ka ndërhyrë në paramasë, sqarojmë se OE ka vendosur çmimin total të pozicioneve të grupit, gjë e cila në asnjë mënyrë nuk ndikon as çmim të ofertës as në poentim të çmimeve apo në asnjë mënyrë tjetër në ofertën e OE ankues. Për më shumë sqarojmë se vendosja nga AK e kolonës “çmimi total” për secilin pozicion përderisa sasia për gjitha pozicionet është “1” (një), është komplet e pakuptueshme dhe e palogjikshme, pasi nuk do të ketë kurrëfarë ndryshimi nga numri fillestar përderisa ai numër shumëzohet me “1” (një)! Kolona e vendosur nga AK “çmimi total” për secilin pozicion, nuk ka kurrëfarë ndikimi çmim të ofruar nga OE-të, andaj vlerësojmë se njëjta nuk duhet përdorur për eliminim të OE-ve, posaçërisht kur AK nuk e ka sqaruar se a duhet vendosur çmimi total i poentuar apo çmimi total i njësisë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat (e paqarta) të dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me nenin 27 par.1 të LPP-së.

Pretendimi nr.2: “Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues është se (sipas AK) se i njëjti ka ofruar katalog nga një prodhues i caktuar (Tiscomed) për të cilin OE ankues nuk ka paraqitur autorizim siç është kërkuar në dosje të tenderit. Po ashtu sipas AK i njëjti OE nuk ka katalogun sipas të cilit për pozicionin 86 specifikat teknik nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes.

Përgjigje nr.2: “ Pas analizimit të ofertës së OE ankues, nuk kemi gjetur se i njëjti nuk ka ofruar autorizim për prodhuesin “Tiscomed”. Po ashtu sipas katalogut të këtij prodhuesi “të nënvizuar nga OE” shihet se specifikat teknike, më konkretisht dimensionet e dyshekut nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes. Produkti i ofruar është i ngushtë dhe më i hollë se ajo çka është kërkuar nga AK, duke përfshirë edhe tolerancën prej $\pm 5\%$, OE ankues prap nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Megjithatë OE ka ofruar një “katalog” në emër të vetin “mobelland”, ashtu siç ka konstatuar AK-KK Prishtinë, vlerësimi i njëjtë si AK, se OE Mobelland nuk është prodhues u inventarit dhe mobileve medicinale, gjë e cila mund të vërtetohet përmes ARBK tek “Aktivitetet” e kompanisë. Përveç kësaj OE ka ofruar katalog nga Tiscomed ku ka nënvizuar produktin/shtratin i cili nuk është në përputhje me specifikat teknike të kërkuara. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore në këto dy pika janë të pabazuara.

Pretendimi nr.3: “OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e AK-së për kontrata të ngjashme në vlerë 900.000€ në tri vitet e fundit.

Përgjigje nr.3: “Pas analizimit të ofertës së OE ankues, vlerësimi ekspertit është se OE i rekomanduar sa i përket kontratave të ngjashme, ka paraqitur dy kontrata për furnizim me “inventar medicinal” përmes të cilave sipas mendimit tonë plotëson dhe tejkalon kërkesat e AK-së në dosje të tenderit, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar. Sai përket pretendimit se OE i rekomanduar ka ofruar deklaratën blanko për specifikacion teknik, sqarojmë se OE i rekomanduar ka ofruar aneksin 1 ashtu siç ka qenë i publikuar nga AK, duke nënshkruar dhe vulosur të njëjtin.

Pretendimi nr.4: “OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka ofruar CV të noterizuar për Arkitekt të brendshëm dhe dizajn.

Përgjigje nr. 4: “Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se CV për personin e paraqitur për këtë pozitë vërtet nuk është e noterizuar, megjithatë duke pas

parasysh llojin e dokumentit “CV”, konsiderojmë se kjo është devijim i vogël i cili nuk përbën ndryshim material nga kërkesat e dosejs së tenderit, pasi edhe sikur të jetë kopja e noterizuar e CV-së, noterizimi kopjes nuk përbën kurrfarë dëshmie për përmbajtjen dhe vërtetësinë e CV-së në fjalë, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimor është vetëm pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.5: “OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kërkesën për dy kamion me peshë 3.5 ton ka ofruar pajisje të cilat tejkalojnë peshën e kërkuar , gjegjësisht ka ofruar kamion me 5.3 ton dhe 4.6 ton,

Përgjigje nr.5: “pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë kemi gjetur se i njëjti ka ofruar dy automjete të cilët peshën e ngarkesës së lejuar e kanë më të vogël se pesha e caktuar nga AK, ndërsa peshën totale e kanë dukshëm më të lartë se ajo e kërkuar nga AK. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pajisjet e ofruara nuk janë në pajtim me kërkesat e dosjes, megjithatë duke u nisur nga praktikat e mëparshme të OSHP-së kjo mbetet në diskrecion të AK-së nëse dallimi në peshë përbën ndryshim i cili mund të vlerësohet si devijim i vogël nga AK-njësia kërkuese, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është vetëm pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.6: “OE ankues pretendon se për kamionin me targa 01-108-OS OE i rekomanduar ka paraqitur librezën e qarkullimit me afat të regjistrimit të skaduar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu për kamionin me targa 01-894-2B pretendon se OE i rekomanduar ka paraqitur librezë ku nuk shihen fare të dhënat dhe pretendon se sigurisht edhe ky automjet ka regjistrimin e skaduar.

Përgjigje nr. 6: “Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë kemi gjetur se për automjetin me targa 01-08-OS ka afatin e regjistrimit deri me 13.10.2024, andaj pretendimi ankimorë është i pabazuar. Ndërsa për automjetin me targa 01-894-ZB shihet se i njëjti ka regjistrim deri me 11.09.2024, andaj edhe ky pretendim vlerësojmë se është i pabazuar.

Pretendimi nr.7: “OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë për pozicionet 25 dhe 86 nuk kishte ofruar fare katalog , dhe AK në kundërshtim me LPP (sipas OE ankues) kishte kërkuar të njëjtin me sqarime shtesë për pozicionin 86. OE ankues po ashtu pretendon se për këtë katalogu i ofruar në sqarime shtesë është i një prodhuesi për të cilin OE nuk ka fare autorizim siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Pergjigje nr.7: “Pas analizimit të ofertës dhe sqarimeve të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se i njëjti ka ofruar përmes sqarimeve shtesë një katalog për firgorifer medicinal, nga prodhuesi ARI Technology Group Ltd, për të cilin OE nuk ka ofruar autorizim. Vlerësimi jonë është se mungesa e autorizimit të prodhuesit ose dilierit të autorizuar e bënë të papërgjegjshme ofertën e OE e rekomanduar për kontratë. Po ashtu vlerësojmë se një dokument i tillë nuk mund të ofrohet përmes sqarimeve shtesë pasi nuk ka mënyrë objektive përmes të cilës mund të vërtetohet se dokumenti (autorizimi) ka ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 72 par.3 të LPP-së. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mobelland” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mobelland” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mobelland” SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mobelland” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e

Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-9889-1-1-1, të anulohet aktiviteti i prokurimit në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit mund ta ri-tenderojë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që të anulohet vendimi për dhënie të kontratës. Dhe nëse edhe me tutje AK ka interes aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "Mobelland" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: